

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaCeram® Epoxy Remover

PASTRUES PËR MBETJET E BOJAKUT EPOKSID

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaCeram® Epoxy Remover është një produkt me bazë uji për heqjen e mbetjeve të bojakut epoksid.

PËRDORIMET

- Heq nga pllakat qeramike ose porcelani mbetjet e lehta ose të rënda të bojakut epoksid si SikaCeram® Epoxy Remover.
- Përdoret i holluar, pastron dhe largon yndyrën nga dyshemetë shumë të pisëta me pllaka porcelani ose qeramike.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Produkt i posaçëm për bojakun epoksid Sika
- Efikas edhe pas disa ditëve nga aplikimi i bojakut
- Përdorim i lehtë

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Produkt me bazë uji. Përmban: EDTA dhe kripëra ≤ 5%, sapun midis 5% dhe 15%. Përbërës të tjerë: aromë.
Ambalazhi	shishe plastike 2 kg ose 5 kg
Ngjyra	Lëng me ngjyrë të verdhë të zbehtë
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në temperatura midis +5°C dhe +30°C
Dendësia	~ 1.01 kg/l
Vlera e pH	~ 11.3

UDHËZIME APLIKIMI

APLIKIMI

SikaCeram® Epoxy Remover duhet të përdoret i holluar ose i paholluar me ujë, sipas kërkesës.

Si të hiqni mbetjet shumë të thara të bojakëve epoksidë

Hidhni përsipër produktin e paholluar; lëreni të veprojnë për 15-20 minuta, pastaj fërkoni me një copë

abrazive dhe shpëlani; nëse është e nevojshme, përdorni një mallë metalike për të kruajtur bojakun nga pllakat, pastaj fërkoni me një copë abrazive.

Si të largoni njollat e lëna nga bojaku epoksid ose si ta përdorni për largimin e yndyrave/ dyllit

Holloni produktin me ujë në raportin 1:5, aplikoni dhe lëreni të veprojnë për disa minuta; fërkoni me një copë ose përdorni një furçë abrazive ose pastrues me 1 disk, vakuum ose fshini pisllekun dhe shpëlani me ujë të bollshëm.

Si të largoni njollat nga gresi i porcelanit

Hidhni produktin të paholluar mbi njollën dhe në të gjithë pllakën; lëreni produktin të veprojë për 15-20 min, pastaj fërkoni me një copë abrazive dhe shpëlani.

KUFIZIME

- Përdorimi i SikaCeram® Epoxy Remover mbi bojakun epoksid duhet bërë të paktën 48 orë pas mbushjes së fugave, 24 orë nëse temperatura e ambientit është ≥ +20°C.
- Të mos përdoret mbi mermer ose gur të lyer.
- Të mos përdoret mbi drurin.
- Të mos përdoret në vaska methakrilati.
- Testoni sipërfaqen për t' u siguruar se nuk është e dëmtuar përpara aplikimit të SikaCeram® Epoxy Remover

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaCeram® Epoxy Remover

Mars 2019, Botimi 02.01

020404200010000054

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaCeramEpoxyRemover-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf

